



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 30, DATË 22.04.2020

PËR

ÇELJEN E PROCEDURËS PËR LËSHIMIN E LICENCAVE LOKALE TË  
SHËRBIMIT PROGRAMI AUDIOVIZIV

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, neneve 60 dhe 67 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Berat.
2. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Fier.
3. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Korçë.
4. Shpalljen në mënyrë publike të çeljes së procedurës për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA